

**Komisioni kombëtar për UNESCO e Republikës së Maqedonisë së Veriut informon se thirrja e publikuar nga ana e UNESCO për shtetet anëtare për paraqitjen e propozim-projekteve në suaza të Programit për pjesëmarrje në UNESCO për periudhën e viteve 2022-2023**

Në bazë të Rezolutës 41 C/48 të miratuar në konferencën e Përgjithshme të 41 të UNESCO në vitin 2021, ftohen shtetet anëtare përmes komisioneve të tyre kombëtare të UNESCO, të dorëtojnë tek UNESCO më së shumti 7 propozim-projekte nga 5 fushat kryesore programore të UNESCO: arsimi, shkencat natyrore, shkencat sociale, kultura, komunikimi dhe informacioni, dhe 1 projekt rajonal jo më vonë se 28 shkurt të vitit 2022.

**Kushtet e aplikimit:**

**Mbajtësi i projektit:** Person juridik që mund të sigurojë implementimin cilësor të projektit

Korniza dhe objektivat e projektit: Projekti duhet të jetë në përputhje me prioritetet e miratuara të UNESCO për 5 fushat kryesore të programit: arsim, shkenca natyrore, shkenca sociale, kulturës, komunikimit dhe informacionit për periudhën e viteve 2022-2025 të përfshira në dokumenti 41 C/5 Buxheti dhe programi i viteve 2022 – 2025.

<https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000375756>

**Niveli dhe buxheti i projektit:** Në mbarë vendin - projekte me mbështetje financiare deri në 26 000

Dollarë amerikan, në nivel nënrajonat dhe ndërrajonat - projekte me mbështetje financiare deri në 28,000 dollarë amerikan dhe në rajon - projekte me mbështetje financiare deri në 38,000 dollarë amerikan.

**Afati për realizimin e projekteve të miratuara: 31.12 të vitit 2023**

Theksojmë se për projektet në nivel rajonal, nënrajonat dhe ndërrajonat, me ndërmjetësimin e Komisionit Kombëtar për UNESCO, është e nevojshme të sigurohen 2 deri në 3 letra për mbështetje nga vendet e tjera. Në mënyrë që Komisioni Kombëtar për UNESCO-n të paraqesë propozim-projektet në përputhje me afatin e caktuar, personat juridikë janë të detyruar të dorëzojnë formularët e plotësuar në anglisht ose frëngjisht, si dhe në maqedonisht, për Komisionin Kombëtar për UNESCO jo më vonë se 10 shkurt të vitit 2022.

Përveç formularit në letër, propozim -projektet duhet të dorëzohen në formë elektronike në adresat e postës elektronike të listuara në këtë thirrje, në mënyrë që ato të dorëzohen nga Komisioni Kombëtar për UNESCO e Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes platformës online të UNESCO.

Kujtojmë se projekt propozimet e dorëzuara pas afatit 10 shkurt 2022 nuk do të merren parasysh, si dhe ato që nuk do të jenë të plotësuara plotësisht.

Informacion më të detajuar reth Programit të Pjesëmarrjes në UNESCO për periudhën e viteve 2022 - 2023 dhe procedurën e dorëzimit të propozim- projekteve së bashku me formularët mund të merren dhe shkarkohen nga linku në vijim:

[https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000380181\\_eng.locale=en](https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000380181_eng.locale=en)

Adresa për dorëzimin e propozim- projekteve me postë dhe në mënyrë elektronike:

Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë së Veriut

rr. "Gjuro Gjakoviq" "nr. 61

1000 Shkup

Adresat elektornike:

[t.kraljevska@kultura.gov.mk](mailto:t.kraljevska@kultura.gov.mk) dhe [ljupco.smilev@kultura.gov.mk](mailto:ljupco.smilev@kultura.gov.mk)

Telefonat: 02/3240 591 dhe 3240 517